



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina

01-599

Në bazë të nenit 21, 22, 44, 50 dhe 84 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 8 të Ligjit nr. 04/L-110 për Ndërtim, nenit 17, pika d të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, dt. 20.02.2008, nenit 15 pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr. 110-391, dt. 25.02.2010, si dhe në bazë të kërkesës 05 Nr. 350/03-35395/24 dt.11.03.2024, të aplikuesve / bashkëpronarëve Ramadan dhe Hidajete Haliti, me adresë në Rr. Hysni Hajdarmataj, Nr.30, në Prishtinë, për përmirësimin e gabimit teknik të emrit të njërit nga bashkëpronarët e parcelës kadastrale nr.417-8, ZK Çagllavicë, në aktin administrativ – Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore, 05 NR.350/02-106203/23 dt. 28.12.2023, të lëshuar nga kjo drejtori, në emër të Ramadan dhe Halime Haliti, për caktimin e kriterëve të ndërtimit në hartimin e dokumentacionit ndërtimor dhe lejimin e ndërtimit të ndërtesës/ shtëpisë individuale të banimit në kuadër të Planit Rregullues “Prishtina e Re-Zona Perëndim” në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë të rregullt administrative, me datë 25.04.2024, merr këtë:

## V E N D I M

### PËRMIRËSOHET GABIMI TEKNIK NË AKTIN ADMINISTRATIV “VENDIM PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE, 05 NR.350/02-106203/23 DT. 28.12.2023”

I. MIRATOHET kërkesa 05 Nr. 350/03-35395/24 dt.11.03.2024 e aplikuesve/bashkëpronarëve Ramadan dhe Hidajete Haliti, me adresë në Rr. Hysni Hajdarmataj, Nr.30, në Prishtinë, për ndryshimin e aktit administrativ “Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore” 05 NR.350/02-106203/23 dt. 28.12.2023, përkatësisht, ndryshimin e emrit të njërit nga bashkëpronarët e parcelës kadastrale me nr.00417-8, ZK Çagllavicë, i lëshuar nga kjo drejtori.

II. Ndryshohet Vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore 05 NR.350/02-106203/23 dt. 28.12.2023, i lëshuar nga kjo drejtori, në emër të Ramadan dhe Halime Haliti nga Prishtina, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin ideor, për ndërtimin e shtëpisë individuale me etazhitet B+P+2, në kuadër të Parcelës ndërtimore: “I-21-11”, të Bllokut urban “I-21” të Tërësisë “I”, të Planit Rregullues “Prishtina e Re-Zona Perëndim” në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr.417-8, ZK Çagllavicë.

Ndryshimi i vendimit, sipas pikës I të këtij akti, ka të bëjë me përmirësimin e gabimit teknik të emrit të njërit nga bashkëpronarët e parcelës kadastrale me nr.417-8, ZK Çagllavicë, në kuadër të së cilës janë caktuar kushtet e ndërtimit, sipas përshkrimit në paragrafin I. të këtij akti, dhe bëhet në tërë përmbajtjen e tekstit të aktit të ndryshuar, dhe atë në vend të: “ ...pronarëve ... Halime Haliti nga Prishtina,...” shënohet “....pronarëve .... Hidajete Haliti nga Prishtina,...”.

III. Ky vendim do të jetë pjesë përbërëse e Vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore 05 NR.350/02-106203/23 dt. 28.12.2023, dhe i njëjti do të prodhojë efekt juridik nga dita e miratimit të tij.

Faqe 1 prej 2

Komuna e Prishtinës  
Drejtoria e Urbanizmit  
Adresa: rr. “Radovan Zogoviq” nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë  
Telefon: + 383 (0) 38 221 242

e-mail: [urbanizmi@prishtine.rks.gov.net](mailto:urbanizmi@prishtine.rks.gov.net)

## Arsyetim

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, ka pranuar kërkesën 05 Nr. 350/03-35395/24 dt.11.03.2024, të parashtruar nga bashkëpronarët Ramadan dhe Hidajete Haliti, me adresë në Rr. Hysni Hajdarmataj, Nr.30, në Prishtinë, për ndryshimin e Vendimit 05 NR.350/02-106203/23 DT. 28.12.2023, sipas të cilit janë caktuar kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin ideor, për ndërtimin e shtëpisë individuale me etazhitet B+P+2, në kuadër të Parcelës ndërtimore: "I-21-11", të Bllokut urban "I-21" të Tërësisë "I", të Planit Rregullues "Prishtina e Re-Zona Perëndim" në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr.417-8, ZK Çagllavicë.

Bashkë me kërkesë janë prezantuar: Kopje e Vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore, 05 NR.350/02-106203/23 DT. 28.12.2023, të lëshuara nga kjo Drejtori; Kopje e letërnjoftimit të pronarëve të parcelës kadastrale me nr.417-8, ZK Çagllavicë, dhe Kopje e Autorizim për përfaqësim me LRP.NR.:4204/2023dt.25.05.2023.

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, pas shqyrtimit të kërkesës, dokumentacionit të prezantuar, konsultimit të rregullativës ligjore nga lëmi i ndërtimit, planifikimit dhe procedurës administrative, ka konstatuar se me aktin administrativ "Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore, 05 NR.350/02-106203/23 DT. 28.12.2023", kjo drejtori ka përcaktuar kriteret ndërtimore për emër të pronarëve Ramadan dhe Halimë Haliti nga Prishtina, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin ideor, për ndërtimin e shtëpisë individuale me etazhitet B+P+2, në kuadër të Parcelës ndërtimore: "I-21-11", të Bllokut urban "I-21" të Tërësisë "I", të Planit Rregullues "Prishtina e Re-Zona Perëndim" në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr.417-8, ZK Çagllavicë.

Me kërkesën 05 Nr. 350/03-35395/24 dt.11.03.2024, aplikuesit / bashkëpronarët Ramadan dhe Hidajete Haliti, i janë drejtuar kësaj drejtorie për përmirësimin e gabimit teknik të emrit të njërit nga bashkëpronarët e parcelës kadastrale me nr.417-8, ZK Çagllavicë, në aktin administrativ "Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore 05 NR.350/02-106203/23 DT. 28.12.2023, të lëshuar nga kjo drejtori duke dëshmuar se Ramadan dhe Hidajete Haliti janë bashkëpronar të parcelës kadastrale me nr. 417-8, ZK Çagllavicë. Kjo drejtori, në procedurë të shqyrtimit të kësaj kërkesë, konstaton se, është lëshuar gabim teknik në përshkrimin e emrit tek Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore, 05 NR.350/02-106203/23 DT. 28.12.2023", dhe atë është dashur të jetë Hydajete Haliti në vend të Halime Haliti. Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të vendimit.

**Udhëzim juridik:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj Drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij Vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo Drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror- MMPHI.

**Ky Vendim u shtyp në 6 (gjashtë) kopje identike fizike dhe i dërgohet:** Kërkuarit/ve; Drejtorisë së Inspektionit; kësaj Drejtorie, në dosje të lëndës 05-351/05-05 NR.350/02-106203/23, në dosje të lëndës 05 Nr. 350/03-35395/24 dt.11.03.2024, dhe Qendrës për Shërbim me Qytetarë.

**Kopje elektronike i dërgohet:** Drejtorisë së Planifikimit Strategjik.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,**  
**05 NR. 350/02-106203/23 DT. 25.04.2024**

Zyrtari,  
Bahtie Uka



Udhëheqëse e Sektorit,  
Nazife Krasniqi



Faqe 2 prej 2

Komuna e Prishtinës  
Drejtoria e Urbanizmit  
Adresa: rr. "Radovan Zogoviq" nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë  
Telefon: + 383 (0) 38 221 242

e-mail: [urbanizmi@prishtine.gov.net](mailto:urbanizmi@prishtine.gov.net)